



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/253
Datë: 21.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Posta e Kosovës Sh. A.", emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Gëzim Paci, kryesues;
 - 1.2. Safija Beseni, anëtare;
 - 1.3. Sebahate Rexha, anëtare;
 - 1.4. Visar Nura, anëtar.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi, kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, dhe me dispozitat e tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjat tri (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

për
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë